

SPECIFIKIME TEKNIKE

**OBJEKTI : " PUNIME TË NDRYSHME ME SINJALISTIKËN
RRUGORE, MIRËMBAJTJE TË SINJALISTIKËS
EKZISTUESE, RRUGË NË ZONAT URBANE TË TERRITORIT
TË BASHKISË KRUJË"**



2026**SPECIFIKIME TEKNIKE****PJESA I****SPECIFIKIME TE PERGJITHSHME DHE PARAPRAKE****1.01 Paraprake**

Kushtet e Kontrates, Vizatime e projektit dhe Preventivi (tabela e volumeve) do te lexohen ne lidhje me keto Specifikime dhe ceshtjet te cilave u referohen, ceshtjet qe tregohen apo pershkruhen ne secilen prej tyre nuk perseriten detyrimisht ne te treja rastet.

Ne raste mosperputhjesh ne lidhje me te njejten ceshtje midis ketyre Dokumenteve, rendi mbizoterues do te jete si me poshte:

- Oferta dhe Shtojcat e ofertes
- Kushtet e Kontrates, Pjesa C
- Kushtet e Kontrates, Pjesa B
- Specifikimet e Vecanta
- Specifikimet e pergjithshme
- Vizatime projekti
- Preventivi (tabela e volumeve)

1.02 Objekti i punimeve

Punimet ndahen: Punime sinjalistike në territorin e bashkisë Krujë.

1.03 Referencat

Standardet e references jane ato italjane CNR, UNI dhe ato te Ministrise te Puneve Publike (per rastet e Betonit te bazamenteve të tabelave Standardet e vendeve te tjera te EEC dhe ato te Shteteve te Bashkuara (BSS, AFNOR, ASTM, AASHTO etj) konsiderohen si ekuivalente.

1.04 Klauzola qe nuk aplikohen

Cfaredo Klauzole e Specifikimeve qe lidhet me punime apo materiale qe nuk kerkohen ne Preventiva (tabela e volumeve) do te konsiderohet si e pa aplikueshme.

1.05 Informacioni ne lidhje me gropat e proves

Informacioni ne lidhje me pozicioni e shpimet dhe gropat per prove te Kantierit dhe pershkrimi i dherave dhe materialeve te ndryshme jepet tek vizatimet e projektit. Kontraktori mendohet se e ka marre dhe vleresuar informacionin gjate pergatitjes se ofertes se tij, si edhe ka bere prova te tjera qe ai i ka menduar si te nevojshme. Asnje kerkese per kompensim (ankese) per pagese shtese nuk do te merret parasysh nga Kontraktori mbi argumentin qe informacioni ka qene i pamjaftueshem, jo i sakte apo qe te nxjerr ne perfundime te gabuara.

1.06 Furnizimi me uje

Perpara se te dorrezoje oferten, Kontraktori do te beje nje investigim nese ka uje te majftueshem per qellimin e Punimeve te tij dhe do te konsultohet dhe do te rregulloje me autoritetet perkatese, si edhe do te marre parasysh te gjitha aspektet ligjore. Kontraktori do te jete plotesisht pergjegjes per furnizimin e sasise se mjaftueshme te ujit te cilesise se specifikuar gjate gjithe kohes se Kontrates. Kostot e furnizimit me uje do te merren si te mbuluara ne cmimet dhe perqindjet e Kontrates.

1.07 Kushtet atmosferike dhe permbytjet

Do te merret si e mireqene qe Kontraktori gjate pergatitjes se ofertes se tij do te kete marre parasysh te gjitha kushtet e mundshme atmosferike dhe rastet e permbytjeve ne kohen e perfundimit si edhe gjate Punimeve Permanente dhe te Perkohshme. Kontraktorit nuk i takon asnje pagese shtese si

pasoje e ndodhjes, vazhdimësisë apo efektit të erërave të forta, bores, acarit, shirave dhe permbytjeve, temperaturave apo lageshtirës apo si pasoje e kushteve të tjera meteorologjike apo hidrologjike.

1.8 Vizatimet e kontrates

Vizatime e Kontrates paraqiten në Vellimin të ketyre Dokumenteve të Tenderit. Ketu nuk do të aplikohet asnjë vizatim që lidhet me struktura standarde/tip apo me punime tipike ku një pjesë e se ciles apo e tëra nuk kërkohej nga Preventivi (tabela e vëllimeve) apo që është pjesë e Klauzoles 51 të Kushteve të Përgjithshme.

1.9 Piketimi

Piketimi do të bëhet në përputhje me Vizatimet e projektit të dhëna nga Supervizori apo sipas instruksioneve të Supervizorit. Megjithatë, Kontraktori do të përgjigjet për kryerjen e studimit fillestar mbi gjurmën e rrugës ekzistues dhe do të përgatise vizatimet e projektit të detajuar të ndërtimit, dhe të detajeve të propozuara të ndërtimit për aprovimit të Supervizorit.

1.10 Kuotat

Kuotat e treguara në Vizatimet e projektit lidhen me piketat të përhershme të rrugës ku do vendoset sinjalistika.

1.11 Programi i Punimeve dhe Punimeve të Perkohshme

1. Duke iu referuar Klauzoles 14 të Kushteve të Kontrates, programi i punimeve të Kontraktorit duhet të përmbajë detajet e mëposhtme:

- Radha e punimeve
- Ecurinë e planifikuar (grafiku i punës)
- Kapacitetet dhe llojet e impjanteve të propozuara
- Detajet e metodave që do të përdoren
- Detajet e punimeve të perkohshme
- Të dhëna të detajuara mbi fuqinë punëtore, të kualifikuar ose jo

2. Punimet do të zbatohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë përfundimin e njëpasnjeshëm dhe të plotë të zerave të punës. Radha e zbatimit të Punimeve do të varet nga ndryshimet e mundshme, të justifikuara, që do të bëhen nga Supervizori.

3. Kontraktori do t'i japë Supervizorit për aprovim vizatimet e projektit ku tregohet planimetria (gjurma), si edhe një ide të përgjithshme të Punimeve të Perkohshme që ai propozon të realizojë për qëllimin e Kontrates duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- ✓ Kantieri, duke përfshirë akomodimin e stafit dhe fuqisë punëtore dhe stafin e Supervizorit, në rast se kërkohej;
- ✓ Zyrat
- ✓ Ofcinat
- ✓ Magazinat
- ✓ impjanti i thyerjes së inerteve dhe impjanti i prodhimit të asfalto betonit etj., në rast se ka
- ✓ Impjanti i prodhimit të betonit dhe impjanti i parafabrikimit, në rast se ka.

Kontraktori nuk do të paguhet veç për kostot e mobilizimit dhe çmobilizimit, primet për garancite bankare, sigurimet, duke përfshirë dhe sigurimin e paleve të treta, shtesat, fitimet apo çfaredo lloj kostoje apo tarife tjeter, apo për punime që lidhen me sa më sipër, me përjashtim të rasteve kur çmimet për njësi për të janë përcaktuar në mënyrë specifike tek Preventivi (tabela e vëllimeve) apo janë identifikuar shprehimisht në Kontratë për t'u paguar.

4. Kontraktori do të përfshijë pagesën e Punimeve të Perkohshme në cmimet e tij, me përjashtim të zerave të Preventivit (tabela e vëllimeve).

Në rast se për çfaredo arsye, Supervizori kërkon shërbime dhe mirëmbajtjen e zyres, laboratorit, mjeteve dhe pajisjeve të komunikimit të tij për një periudhë me të gjatë nga ajo që është parashikuar në kohen e Kontrates, Kontraktori do t'i kërkohej të bëjë këto gjë. Pagesat për shërbime dhe mirëmbajtje të tillë do të vendosen me Supervizorin dhe do të aprovohen nga Punëdhënësi.

1.12 Kantieri, ofcinat, magazinat, zyrat etj. e Kontraktorit

Kontraktori do të ndertojë, ruajë dhe mirëmbajë një kantier për punëtorët e tij së bashku me ofcinat, magazinat, zyrat, kushte higjienike dhe pajisjet e ndihmes së shpejte.

Kantieri i ndërtimit dhe ndërtësat e tjera do të aprovohen nga Supervizori. Akomodimi, mensa do të jenë në përputhje me shkallën e Kontrates.

Kantieri dhe ndërtësat e tjera do të mbahen në kushte të mira higjienike. Me përfundimin e Kontrates, të gjitha ndërtësat e lehta dhe Kantieri të siguruara nga Kontraktori do të hiqen po nga Kontraktori pa asnjë kosto shtesë për Punëdhënësin dhe Kantieri do të lihet i pastër dhe në rregull. Çdo pjesë e kampit apo ndërtësive që kërkohej nga Punëdhënësi do t'i jepet Punëdhënësit me një kosto që do të negociohet nga palet.

1.13 Banjat

Gjatë gjithë periudhës së ndërtimit, Kontraktori do t'u sigurojë punëtorëve të tij banjat të mjaftueshme të cilat do t'i mirëmbajë dhe pastrojë; kontraktori do të sigurohet që punëtorët të mbajnë pastër kantierin dhe t'i përdorin mirë banjat.

1.14 Kantieri

Me përjashtim të rasteve kur në Vizatimet e projektit specifikohet ndryshe, Kantieri sic përcaktohet në nen-klauzolën (f) (vii) të Klauzolës 1 të Kushteve të Përgjithshme ka kuptimin e një trualli privat apo publike të caktuar që sipas opinionit të Supervizorit është i nevojshëm apo praktik për zbatimin e Punimeve. Kontraktori nuk do të perdorë Kantierin për qëllime të tjera nga ato të Kontrates.

Kontraktori, kur urdherohet, do të sigurojë fotografi dhe do të regjistrojë me aprovimin e Supervizorit kushtet dhe kuotat e sipërfaqeve të kantierit menjëherë përpara se të futet atje për qëllime ndërtimi.

1.15 Kantieri për nevojat shtesë

Në rast se Kontraktori do të perdorë rrugë të perkoheshme apo akomodim shtesë sipas Klauzolës 42(3) të Kushteve të Përgjithshme apo çdo sipërfaqje për hedhjen dhe vendosjen e materialeve shtesë, ai duhet të ketë pëlqimin me shkrim të Pronarit dhe Zotëruarit apo të Autoritetit që ka në pronësi tokën në të cilën e cila do të perdoret për qëllimet e mesipërme. Në të njëjtën kohë ai do t'i paraqesë me shkrim Pronarit, Zotëruarit apo Autoritetit kushtet e ketyre sipërfaqeve përpara se ai t'i perdorte.

Sipas Klauzolës 37 të Kushteve të Përgjithshme, Kontraktori do t'i lejojë Punëdhënësit dhe Supervizorit, si edhe çdo personi të autorizuar prej tyre të perdorë për qëllimin e Kontrates çfaredo rrugë të perkoheshme apo akomodim shtesë të Kontraktorit. Për përdorimin e saj me sipër, Punëdhënësit nuk do t'i duhet të bëjë asnjë kosto ekstra.

Në rast se Kontraktori duke përdorur rrugët e perkohshme të daljes apo akomodimet shtesë që atij i janë siguruar nga Punëdhënësi për qëllimin e kësaj Kontrate, toka ku ndodhet kjo rrugë e perkohshme daljeje apo ky akomodim shtesë do të konsiderohet si pjesë e Kantierit, ashtu sic përkufizohet në nen-klauzolën (f) (vii) të Klauzolës 1 të Kushteve të Përgjithshme.

1.16 Vizatimet e punës

Përpara se të fillojnë Punimet apo çdo pjesë e tyre, Kontraktori duhet të përgatisë dhe dorëzojë për aprovimin e Supervizorit kopjet (në rastin me të parë) të çfaredo Vizatimi PUNE të detajuar që mund të kërkohej për atë pjesë të punës dhe në të njëjtën kohë t'i tërheqë vëmendjen Supervizorit për diferencat që mund të ekzistojnë midis tyre dhe Vizatimeve të projektit sipas Kontrates. Supervizori, pasi Kontraktori të ketë bërë ndryshimet që mund t'i kërkojë ai, do të regjistrojë në kopjet e ndryshuara aprovimin e tij dhe do t'i kthejë një kopje Kontraktorit që do të zhvillojë punimet sipas ketyre ndryshimeve të aprovuara.

Kontraktori do t'i japë Supervizorit katër kopje të tjera të Vizatimeve të aprovuara të PUNES. Përveç kësaj, duhet të dorëzohen edhe Vizatimet e PUNES (do të ndiqet e njëjta procedurë që përshkruhet me sipër) në lidhje me çdo punë që propozohet të kryhet nga nen-kontraktoret. Aprovimi nga Supervizori i të gjitha Vizatimeve apo pjesëve të tyre nuk e çliron Kontraktorin nga përgjegjësia e kryerjes së punimeve.

1.17 Vizatimet e Planimetrive dhe Profilave

Kontraktori do t'i paraqese per aprovim Supervizorit te gjitha vizatimet e plota te detajuara te planimetrive dhe profilave te seksioneve te rruges ne te cilat ai do te punoje. Keto vizatime duhet te tregojne kuoten e tokes natyrale dhe kuoten sipas projektit te aksit te rruges, mbingritjen e aneve te rrugeve, te dhenat ne lidhje me gjurmen ne planin vertikal dhe horizontal dhe te gjitha detajet e tjera qe mund te kerkohen nga Supervizori.

Kuota terthore e rruges, ne perputhje me kushtet e tjera te vendit ku ajo kalon, duhet te minimizojë volumin e levizjeve te dheut (mbushje/germim).

1.18 Ndryshimi i Vizatimeve te projektit

Ne te gjitha rastet kur per vizatimet specifikohet apo kerkohet te dorezohen nga Kontraktori per aprovimin e Supervizorit, cdo ndryshim ne keto Vizatime qe mund te kerkohet nga Supervizori do te behet nga Kontraktori pa asnje kosto shtese.

1.19 Paraqitja e Vizatimeve te Punimeve te Paparashikuara

Kontraktori duhet t'i paraqese Supervizorit per aprovim, Vizatimet e plota te Punimeve te Paparashikuara qe kerkohen per kryerjen e Punimeve, se bashku me llogaritjet qe lidhen me qendrueshmerine dhe devijimet e pritshme te tyre.

Vizatimet duhet te tregojne metoden e propozuar per realizimin e zerave te ndryshem te Punimeve te Paparashikuara dhe aplikimin e tyre ne kryerjen e Punimeve te Perhereshme.

Te gjitha Punimet e Paparashikuara duhet te projektohen sakte dhe te ndertohen, mire per te mbajtur ngarkesat per te cilat jane logaritur. Te gjitha Vizatimet dhe llogaritjet qe lidhen me to do t'i jepen Supervizorit ne kohe per t'i studjuar me kujdes dhe per te perfshire modifikimet qe mund te kerkoje Supervizori.

Pavaresisht nga aprovimi apo modifikimet qe do te behen nga Supervizori per cdo vizatim te paraqitur per cfaredo Punimi te Paparashikuar, Ndarjet ne Faza etj, Kontraktori do te jete plotesisht pergjegjes deri ne realizimin e ketyre Punimeve, per eficiencen, sigurine dhe mirembajtjen e tyre, si edhe per te gjitha detyrimet dhe rreziqet qe lidhen me Punimet e specifikuara apo te nenkuptuara ne Kontrate. Kontraktori duhet t'i ruaje ne te njejten gjendje sa me siper, dhe ne rast aksidenti apo prishjeje qe mund te shkaktoje demtim apo plagosje, ai do te pergjigjet vete sipas dispozitave te Kushteve te Kontrates qe mund te aplikohen ne raste te demtimeve apo plagosjeve te tilla.

Dy kopje te secilit prej Vizatimeve do t'i dorezohen Supervizorit menjehere dhe ai do te rregjistroje ne keto kopje, te cilat jane ndryshuar dhe modifikuar sipas kerkeses, aprovimin e tij dhe do t'i ktheje nje kopje Kontraktorit i cili pastaj mund te vazhdoje ne perputhje me to. Kontraktori do t'i jape Supervizorit kater kopje te tjera te Vizatimeve te aprovuara.

Kostoja e plotesimit te te gjitha kerkesave te kesaj Klauzole do te perballohet nga Kontraktori.

1.20 Fotografite

Kontraktori me shpenzimet e tij duhet t'i paraqese Supervizorit negativet dhe 3 kopje te stampuara te ecurise se punimeve te marra ne intervale nje-dy mujore, me permasa jo me pak se 180 mm me 120 mm te atyre pjeseve te Punimeve, ne progres dhe te perfunduara sic mund t'i kerkoje Supervizori. Fotografite do te jene prone e Punedhenesit dhe asnje kopje e negativave nuk do t'i jepet asnje personi apo personave pa aprovimin e Punedhenesit apo Supervizorit. Kontraktori do te siguroje albumet e fotografive dhe mbajttese per varjen/ montimin e fotografive.

1.21 Ditari i kantierit

Ne rastet kur specifikohet apo me urdher te Supervizorit, Kontraktori do te marre dhe testojë ekzemplare te materialeve dhe ujit ne dhe perreth germimeve. Kontraktori do rregjistroje per dite pozicionin dhe masen e detajuar te germimeve te cdo lloji shtrese dheu dhe uji nentokesor etj. perpara ndertimit te Punimeve dhe te ekzemplareve te marre dhe rezultatet e provave te ketyre materialeve dhe ujit.

Shenimet dhe provat e materialit do te pergatiten ne nje format qe do te aprovohet nga Supervizori dhe do t'i dergohen atij ne duplikate sapo te jete e mundur nje gje e tille ne menyre qe Supervizori te jape aprovimin per to perpara se te fillojne punimet.

1.22 Kontrolli i trafikut**(1) Programi për kalimin e trafikut**

Pas lidhjes së kontratës, Kontraktori do t'i paraqesë Supervizorit një Program të detajuar për Menaxhimin e Trafikut. Ky program do të aprovohet nga Supervizori përpara se Kontraktori të fillojë punimet. Midis të tjerave programi duhet të tregojë metodat e mbrojtjes së publikut dhe të japë detaje të oreve të funksionimit, vendndodhjes, llojeve dhe numrave të mjeteve të sigurisë së trafikut, barrikadave, shenjave dhe dritave të paralajmërimit, sinjalizuesit, dritat e trafikut etj. Programi për Menaxhimin e Trafikut do të jetë në përputhje dhe plotësues i Programit të Punimeve të paraqitur në 1.13.

Në përgatitjen e këtij Programi të Menaxhimit të Trafikut, Kontraktori duhet të marrë parasysh sa më poshtë:

- kontraktori do të zhvillojë veprimtarinë e tij në mënyrë të tillë që të mos bllokojë me shumë gjatësi rrugë apo sasi pune nga c'mund të realizojë, duke marrë parasysh mirë të drejtat dhe konvencencën e publikut
- në rast se kontraktori propozon mbylljen e rrugës, ai do të sigurojë një rrugë alternative për kalimin e trafikut, e cila duhet të aprovohet nga Supervizori.
- Programi të aprovuar për Menaxhimin e Trafikut nuk do t'i behet asnjë ndryshim pa marrë me parë lejen me shkrim të Supervizorit. Kontraktori do t'i japë Supervizorit 14 ditë kohë për të shqyrtuar çdo kërkesë për rishikimin e Programit për Menaxhimin e Trafikut.
- Programi për menaxhimin e trafikut do të jetë në të gjithë aspektet në përputhje me kërkesat e Specifikimeve të Veçanta.

(2) Kalimi dhe kontrolli i trafikut

Kontrata ka për qëllim që trafiku publik të kalojë përgjatë/nga ato rrugë ku do të zhvillohen Punimet gjatë gjithë kohës së ndërtimit dhe në të gjithë kushtet atmosferike. Për këtë qëllim, Kontraktori i kërket ta rregullojë punën e tij në gjysmën e gjerësisë së rrugës, duke siguruar një korsë me së paku 3.35 metra gjerësi në rrugën ekzistuese. Kontraktori do të vendosë sinjalizues kompetentë për të kontrolluar dhe rregulluar qarkullimin e trafikut në një korsë/me një kalim.

Frekuenca dhe zgjatja e vonesave të kalimit të trafikut vetëm në një korsë gjatë Punimeve duhet mbajtur në minimum. Në asnjë rast ato nuk duhet të jenë më shumë se 1/2 orë dhe normalisht duhet të jenë më pak se 5 minuta. Çdo metodë pune që kërkon mbylljen e plotë të rrugëve për më shumë se 10 minuta duhet të njoftohet 48 orë më para dhe për të duhet të bëhet dakord me Supervizorin, i cili mund të refuzojë mbylljen e kësaj rrugë për shkak se nuk është njoftuar në kohë.

Kontraktori duhet të bejë kujdes kur e kalon trafikun përmes Punimeve të tij që të gjitha gërmimet dhe gjëra të tjera me rrezik të mbrohen siç duhet me barriera dhe të ndriçohen gjatë natës.

(3) Devijimet**a. Të përgjithshme**

Në ato raste kur Kontraktori është i mendimit që do të ishte më mirë që trafiku të mos kalonte përmes Punimeve të tij, Kontraktori me aprovimin paraprak të Supervizorit do t'i lejohet të ndërtojë dhe mirëmbaje devijime, me kusht që këto devijime të jenë të kalueshme në trafik gjatë gjithë kohës në përputhje me dispozitat e paragrafit (5) më poshtë.

Gjatesia e devijimeve duhet të jetë gjatesia me e shkurtër praktike duke marrë parasysh pjerresinë dhe pengesat dhe do të quhet si e rene dakord midis Supervizorit dhe Kontraktorit.

b. Gjerësitë, pjerësitë dhe sistemi i drenazhimit

Për devijimin në një rrugë kryesore ekzistuese, gjerësia e vijës së kalimit të rrugës së perkohshme do të jetë sa gjerësia e vijës ekzistuese të kalimit apo 6 metra, cilado prej tyre të jetë më e vogël.

Për devijimin në një rrugë sekondare publike apo në një rrugë private, gjerësia e vijës së kalimit të rrugës së perkohshme do të jetë e njëjta me vijën e kalimit ekzistues apo ndonjë gjerësi të tillë me të vogël siç do të përcaktohet nga Drejtoria e Rrugëve apo me aprovimin e pronarit, si edhe pasi të merret aprovim i Supervizorit.

Në ato raste kur për mendimin e Kontraktorit është e pamundur të sigurohet një devijim me dy korsë, do të sigurohet një vijë kalimi me një korsë jo më pak se 3.5 metra të gjera për kontrollin e trafikut dhe vendet e kalimit, me aprovimin e Supervizorit.

Pjesa anesore e rruges devijuese do te pastrohet dhe do te mbahet e paster per nje gjeresi se paku 1.5 metra pertej anes se vijes se kalimit dhe per cfaredo gjeresi tjeter per te cilen do te bihet dakord me Supervizorin.

Pjerresia e cdo devijimi nuk duhet te jete me shume se 10%, me perjashtim te rasteve kur eshte marre aprovimi i shprehur i Supervizorit dhe kalimi nga nje pjerresi ne tjetren duhet te behet me kthesa te bute vertikale, per te cilin duhet te jape aprovin Supervizori.

Kanalet anesore dhe tombinot e perkohshme te nje madhesie dhe kapaciteti te pershtatshem do te sigurohen pergjate rruges dhe ne rrugen e perkohshme. Per kete duhet te jape pelqimin Supervizori.

c. Mirembajtja e shtresave

Shtresat e te gjitha devijimeve duhet te mirembahen, te jene pa karrexhata dhe gropa dhe duhen lagur sipas rastit.

(4) *Perdorimi i rrugeve dytesore dhe private si devijim*

Ne ato raste kur Supervizori eshte dakord qe Kontraktori te perdore nje rruge dytesore apo private si devijim, Kontraktori do te jete plotesisht pergjegjes per negociimin dhe marrjen e pelqimit paraprak te Autoritetit Lokal apo te pronarit respektivisht, do te paguaje te gjitha kostot per mirembajtje shtese ose ne rast se eshte e nevojshme do ta mirembaje vete rrugen dytesore per periudhen qe ajo perdoret si devijim dhe pastaj do ta riktheje ate ne kushte te kenaqshme per Autoritetin Lokal apo pronarin ose do te kompensoje Autoritetin Lokal apo pronarin per cdo demtim si rezultat i perdorimit te rruges si devijim.

Standardi i kesaj rruge dytesore apo private kur perdoret si devijim duhet qe se paku te jete ne perputhje me paragrafin (3) me siper per rruget e perkohshme dhe ne rast se shihet e nevojshme Kontraktori me shpenzimet e tij do ta permiresoje rrugen per ta sjelle ate ne standardin qe kishte perpara se te perdorej si devijim dhe do ta mirembaje ate ne ate standard gjate kohes qe perdoret si devijim.

Gjatesia e devijimit nuk duhet te jete shume e madhe dhe duhet te mbahet aq e shkurter sa eshte praktikisht e mundshme.

(5) *Asistenca per publikun*

Kontraktori do te pergjigjet per mirembajtjen e sigurte dhe drejtimin e trafikut permes apo perreth cdo pjese te Punimeve te tij te perfshira ne Kontrate, ne konvencien me te mundshme praktike pergjate 24 oreve te cdo dite.

Kontraktori do t'i siguroje publikut te gjitha asistencen e mundshme gjate kalimit te rrugeve qe mirembahen nga Kontraktori, si edhe gjate kalimit ne rruge dytesore, private apo te perkoheshme ne rastet kur ato perdoren si devijime apo gjate kalimit permes Punimeve te kontraktorit.

Ne te gjitha rastet kur punimet e Kontraktorit krijojne kushtet qe paraqesin rrezik per trafikun apo publikun, Kontraktori do te siguroje, ndertoje dhe mirembaje gardhe, barrikada dhe do te vendose sinjale, apo sherbime te tjera qe do te nevojiten per parandalimin e aksidenteve, demtimeve apo plagosjen e publikut.

Kontraktori do te siguroje rojet dhe sinjalizuesit qe nevojiten per te paralajmeruar ne lidhje me kushte qe mund te paraqesin rrezik per trafikun apo publikun, si edhe do t'i siguroje asistencen cdo makine qe mund te kete veshtiresi gjate kalimit permes Punimeve te tij apo permes cdo devijime apo rruge qe eshte pjese e kontrates se Kontraktorit dhe ne ato raste qe nevojitet do te siguroje makinën terheqese, krahun e punes dhe litarin per terheqjen e makines.

Ne rast se Kontraktori tregohet neglizhent ne vendosjen e shenjave parandaluese apo ne marrjen e masave mbrojtese, sic permendet me siper, Supervizori mund te terheqe vemendjen per ekzistencen e ketij rreziku dhe cdo mase per paralajmerim apo mbrojtje do te merret dhe vendoset nga Kontraktori me shpenzimet e tij. Ne rast se Supervizori zbulon se masat mbrojtese apo shenjat paralajmeruese kane qene te pamjaftueshme apo te vendosura jo siç duhet, ky veprim nga ana e Supervizorit nuk e çliron Kontraktorin nga pergjegjesia per sigurine publike apo nga detyrimi per te siguruar dhe paguar per keto mjete.

(6) *Shenjat dhe barierat*

Kontraktori eshte pergjegjes per sigurimin, ndertimin dhe mirembajtjen si edhe heqjen te gjitha shenjave dhe pengesave qe nevojiten per sigurine dhe konvencien e kalimit te trafikut jo vetem ne

rrugen ekzistuese që do të rindertohej apo rregullohej, në rrugët e perkohshme dhe në rrugët ekzistuese lidhëse, por edhe në të gjitha rrugët dytesore dhe private jashtë kantierit të Punimeve të cilat perdoren si devijime.

"Shenja Drejtimi" të perkoheshme do ngrihet përpara çdo kryqezimi rruge dhe një "Shenje Drejtimi" do ngrihet në kryqezimin e rruges së devijimit dhe rrugëve të tjera dytesore ku mund të ndodhë që si pasoje e trafikut të devijuar të ngatërrohet rruga dhe atëherë do të ngrihen tabela të tilla ku të shkruhet "Devijim" rrugë me një shigjetë.

Përvec masave të mesiperme, çdo rrezik tjetër si urë e ngushtë, rrjedhë, kuote terthore, koder e pjerret, kthesë e fortë etj. që mund të jenë pjesë e devijimit do të shenohen nga Kontraktori me tabelën e duhur, në rast se tabela ekzistuese është e pamjaftueshme, apo mund edhe të mos ketë shenjë fare. Të gjitha kthesat e forta dhe të gjitha vendet ku bankina e rruges është me e lartë se 1.2 metra mbi token natyrore do të shenohen me piketa të lyera me bojë.

(7) Sigurimet

Kontraktori duhet t'i kushtojë vëmendje të vecantë Klausolës 22 "Dëme ndaj Personave dhe Pronës" dhe Klausolës 23 "Sigurimi i Paleve të Treta" të Kushteve të Kontrates dhe do t'i paguajë si dëmshperblim Punedhënesit të gjitha humbjet dhe kërkesat për kompensim në rastë plagosjeje apo dëmtimi ndaj personit dhe pronave, që mund të ndodhin si pasoje e kalimit të trafikut, qoftë përmes Punimeve apo në devijimet e ngritura si pjesë e kontrates apo në rrugët ekzistuese publike apo rrugët private të përdorura si devijim.

(8) Gjobat në rastet kur Kontraktori nuk vepron në përputhje me Specifikimet

Në rast se Supervizori nuk është i kenaqur me Kontraktorin për sa i përket përmbushjes së Specifikimeve nga ana e këtij të fundit dhe pasi Supervizori e ka njoftuar në kohën e duhur Kontraktorin dhe n.q.s Kontraktori edhe në këtë rast nuk arrin të veprojë në përputhje me dispozitat e Specifikimeve, atëherë Supervizori do të zbrese nga pagesat që i takojnë Kontraktorit të gjitha shpenzimet e arsyeshme që ka bërë Punedhënesi si rezultat i faktit që Kontraktori nuk arritur të veprojë siç duhet në përputhje me dispozitat e Specifikimeve.

(9) Pagesat

Pagesa për masat për mirëmbajtjen e trafikut, devijimet e rrugëve dhe mirëmbajtjen e rruges gjatë punimeve do të paguhet si një shumë e vetme sipas Artikullit G.2 të Preventivit si më poshtë vijon:

- Shuma e vetme (lump sum) e ofruar nga Kontraktori do ulet në një përqindje të Cmimit të Kontrates dhe e njëjta përqindje i shtohet çdo kesti mujor të paguar nga Kontraktori dhe të aprovuar nga Supervizori. Gjithashtu, kjo pagesë do të jetë subjekti i reduktimit për shumën e garancisë (Retention Money) siç specifikohet në Kushtet e Kontrates.

1.23 Cilesia e materialeve dhe krahut të punës

Të gjitha materialet e përfshira në Punimet e Përherëshme do të jenë në përputhje me klauzolat përkatëse të këtyre Specifikimeve. Po kështu edhe krahut i punës duhet të jetë në përputhje me Specifikimet dhe të gjithë duhet të kenë aprovimin e Supervizorit.

1.24 Aprovimi i Furnizueseve të materialeve dhe mallrave

Përpara se Kontraktori të hyjë në një nën-kontratë për furnizimin e materialeve apo mallrave, ai duhet të ketë për këtë qëllim aprovimin me shkrim të Supervizorit për Furnizuesin nga i cili Kontraktori propozon të marrë mallrat dhe materialet. Në rast se Supervizori në çfarëdo momenti është i pënaqur me këtë mallra apo materiale apo me metodat apo operacionet që kryhen në punimet apo vendin ku zhvillon biznesin Furnizuesi, Supervizori ka fuqinë të anullojë aprovimin me shkrim që ka bërë vetë me parë për këtë Furnizues dhe ka të drejtën të propozojë furnitore të tjera për furnizimin e atyre mallrave apo materialeve. Kontraktori atëherë do t'i marrë ato mallra apo materiale nga ata furnitore dhe është vetë përgjegjës për pagesën e kostove shtesë të tyre.

1.25 Ekzemplaret/kampionet

Përvec dispozitave të vecanta të përfshira këtu për zgjedhjen për provë dhe testimin e materialeve, Kontraktori do t'i dorëzojë Supervizorit, sipas kërkesës së tij, ekzemplare të këtyre materialeve apo

mallrave të cilat Kontraktori propozon të perdore apo vere në punë për Punimet e tij. Keto ekzemplare, në rast se aprovohen, do të mbahen nga Supervizori dhe asnjë lloj tjetër materiali apo malli i ndryshëm nga ai që është dorezuar Supervizorit nuk do të perdoret për Punimet e Përfundimtare, vetëm në rast se për keto ekzemplare Kontraktori ka aprovimin me shkrim të Supervizorit. Pavarësisht nga aprovimi i Supervizorit, vetë Kontraktori është plotësisht përgjegjës për cilësinë e materialeve dhe mallrave të furnizuara.

Supervizori mund të mos pranojë çfarëdo materiali apo malli që në mendimin e tij është i një cilësie me të dobët nga ajo e ekzemplarit që ka aprovuar me parë dhe Kontraktori do t'i heqë menjëherë ato materiale apo mallra nga Kantieri dhe do të sigurojë mallra dhe materiale të tjera që do të gjejnë aprovimin e Supervizorit me shpenzimet e tij (kontraktorit).

Kostoja e furnizimit të këtyre ekzemplareve dhe i sjelljes së tyre në vendin e inspektimit apo të testimit do të jetë brenda çmimeve dhe përqindjeve të tenderuara.

Në ato raste kur është specifikuar marka e prodhuesit, prodhimi i një prodhuesi tjetër do të pranohet vetëm me kusht që sipas mendimit të Supervizorit ky produkt është në të gjitha aspektet i një cilësie të njëjtë apo me të lartë.

1.26 Testet/provat

Supervizori mund të ekzaminojë dhe mund të kërkojë testimin e çdo materiali apo malli që kërkohej të perdoret për apo gjatë Punimeve si ta vendose ai vetë herë-herës dhe do të ketë akses të pakufizuar në premisat e Kontraktorit për këtë qëllim gjatë gjithë kohës.

Kontraktori do t'i sigurojë Supervizorit të gjitha lehtësitë, asistencën, krahun e punës dhe pajisjet që nevojiten për ekzaminimin, testimin, peshimin apo analizimin e të gjithë këtyre materialeve apo mallrave.

Kontraktori do të përgatisë dhe sigurojë testimin e materialeve dhe mallrave me kërkesën e Supervizorit.

Pavarësisht nga testet që mund të jenë bërë jashtë Kantierit, Supervizori ka të drejtë të bëjë prova të tjera të metejeshme të çfarëdo materiali apo malli në Kantier, si edhe ka të drejtën të mos pranojë ato materiale dhe mallra që nuk e kalojnë proven në Kantier.

Kostoja e plotë e të gjitha lehtësive, krahut të punës dhe pajisjeve që kërkohej në lidhje me provat që do të behen në Kantier mëndohen si të përfshira në përqindjet dhe cmimet e ofertes.

Programi i Kontraktorit duhet të sigurojë kohën e duhur për testimin e materialeve. Nuk do të pranohet asnjë ankese (kërkese për kompensim) për vonesa apo kosto shtesë si pasoje e sa më sipër.

1.27 Certifikatat e proves

Në rast se Supervizori nuk i ka inspektuar Certifikatat e materialeve apo mallrave në vendin e prodhimit të tyre, Kontraktori do të marrë Certifikatat e Proves nga Furnitori të atyre mallrave dhe do t'i dërgojë ato Supervizorit. Keto certifikate vertetojnë që materialet dhe mallrat për të cilat bëhet fjalë janë provuar në përputhje me kërkesat e Specifikimeve dhe do të japin rezultatet e të gjitha provave të kryera.

Kontraktori do të sigurojë pajisjet/mjetet e përshtatshme për identifikimin e materialeve dhe mallrave që do të dorëzohen në Kantier me Certifikatat korresponduese.

Të gjitha kostot që kanë dalë në përputhje me këto Klausole do të konsiderohen si të përfshira në cmimet dhe përqindjet e ofertes.

Kostoja e inspektimeve eventuale të Supervizorit në vendin e prodhimit konsiderohet si e mbuluar në Shumën e punimeve të paraparashikuara.

Të gjitha materialet e furnizuara për përdorim gjatë Punimeve duhet të jenë brenda tolerancave të specifikuara, në cilësinë e ekzemplareve të aprovuar që do të mbahen në zyrën e Supervizorit deri në përfundim të Kontrates.

1.28 Mbrojtja e materialeve nga kushtet atmosferike

Të gjitha materialet do të magazinohen në Kantier në një mënyrë të miratuar nga Supervizori. Kontraktori duhet të mbrojë me kujdes nga kushtet atmosferike të gjitha Punimet dhe materialet që mund të ndikohen si pasoje e tyre.

1.29 Raportimi i aksidenteve apo ngjarjeve te pazakonta

Pavaresisht nga dorezimi i raporteve te rregullta mujore mbi ecurine e punimeve, Kontraktori do t'i raportoje Supervizorit menjehere dhe me shkrim, gjithcka ne lidhje me aksidentet apo ngjarje te pazakonta apo te papritura ne Kantier- pavaresisht ne ndikojne ose jo ne ecurine e Punes- duke permendur gjithashtu edhe hapat qe ai ka ndermarre apo qe po merr ne lidhje me kete ceshtje.

1.30 Punime te tjera

Gjate jetes se kontrates, Punedhenesi mund te shkaktoje kryerjen e Punimeve te tjera si instalimin e sherbimeve permes apo ngjitur me Kantierin.

Kontraktori gjate gjithë kohes do te veproje ne perputhje me kerkesat e Kushteve te Pergjithshme te Kontrates ne lidhje me keto dhe me Punime te tjera te paperfshira ne Kontrate dhe do t'i lejoje aksesin permes kantierit te Punimeve sipas miratimit te Supervizorit per cdo Kontraktor tjetër apo punetore qe mund te jene duke punuar ne apo prane Kantierit.

1.31 Lidhjet me zyrtaret qeveritare dhe ata te policise

Kontraktori do te mbaje lidhje te ngushta me zyrtare te Policise dhe qeverise ne lidhje me kontrollin e trafikut dhe ceshtje te tjera, si edhe do t'u siguroje atyre per zbatimin e detyres te gjithë asistencen dhe lehtesite sipas kerkeses se tyre.

1.32 Rregulloret e ndertimit

Te gjitha ndertesat e ngritura nga Kontraktori ne kantier dhe planimetria e ndertesave dhe kantiereve duhet te jete ne perputhje me ligjet shqiptare dhe te gjitha e tjera nen-ligjore ne fuqi.

1.33 Pune e kryer jo-mire

Cdo pune qe nuk perputhet me Specifikimet e Punes nuk do te merret parasysh/do te hidhet poshte. Kontraktori me shpenzimet e tij do te korrigjojë te gjitha defektet sipas urdherit te Supervizorit.

1.34 Tabelat lajmeruese

Kontraktori do te siguroje dhe vendose nje Tabele ne dy hyrjet kryesore te Kantierit dhe ne zyrat e kantierit, kur kjo kerkohet nga Supervizori. Kjo table, me brendashkrimet e duhura, do te perfshije titullin e Projektit, emrin e Punedhenesit, emrin e Institucionit Financues, emrin e Supervizorit dhe emrin e Kontraktorit.

Tabela me permase 2.00 x 2.50 metra duhet te miratohet me pare nga Supervizori dhe pastaj te varet.

Nuk do te kete pagese te vecante per sigurimin dhe vendosjen e te treja tabelave lajmeruese, duke qene se kostoja e tyre eshte e perfshire ne Preventiv nga Kontraktori.

1.35 Urdheri me shkrim

"Urdher me shkrim" do te thote cdo dokument apo leter e firmosur nga Supervizori dhe e derguar me poste apo qe i jepet Kontraktorit dhe ku Kontraktorit i jepen instruksione, udhezime apo drejtime ne lidhje me Kontraten.

Pavaresisht ne perdoren fjalet: miratuar, drejtuar, autorizuar, kerkuar, lejuar, urdheruar, treguar, perfshire edhe emra, folje, mbiemra dhe ndajfolje te se njejtës rendesi, do te kuptohet qe shprehin miratimin, drejtimin, udhezimin, autorizimin, kerkesen, lejen, urdherin, instruksionin etj. te Supervizorit.

PJESA 2**Cilesia dhe Burimet e Materialeve****2.01 Karakteristikat e Materialeve**

Materialet qe do te perdoren gjate punimeve duhet ti permbahen standarteve dhe rregullave nderkombetare per materialet e punimeve civile, edhe per sa i perket nivelit cilesor dhe kushteve te sigurise te percaktuara ne udhezuesin EEC 89/106.

Ne rast se nuk ka kerkesa specifike materialet duhet te jene te cilesise me te mire qe ekziston ne treg dhe qe perdoren per qellimin e caktuar.

Megjithate, materialet duhet te aprovohen nga Supervizori perpara se te vihen ne perdorim.

2.02 Burimet e materialeve

Materialet do të sigurohen nga ato burime ose fabrika që konsiderohen të pershtatshme nga Kontraktori, duke u siguruar se zbatohen rregullat e mësipërme.

Në rast se Supervizori refuzon materialet si të papershtatshme për përdorim, atëherë, Kontraktori duhet të zëvendësojë ato me materiale të tjera që i korrespondojnë karakteristikave të dëshiruara; materialet e refuzuara duhet të hiqen nga vendi i ndërtimit nën kujdesin dhe me shpenzimet e Kontraktorit.

Megjithatë, aprovimin e materialeve nga Supervizori, Kontraktori mbetet përgjegjës i plotë për punën e specialistëve si edhe të vetë materialeve.

PJESA 3

BETONI I ZAKONSHEM

3.01 Te përgjithshme

Kontraktori me shpenzimet dhe nën kujdesin e tij do të bëjë kontrolle për të parë stabilitetin e strukturave që përshihen në tender, si edhe do të përgatisë detajet e ndërtimit, vizatimet e projektit dhe llogaritjet e sasive përkatëse brenda periudhave kohore të caktuara nga Supervizori.

Për të caktuar/vendosur kapacitetin mbajtës të tokës/dheut, si edhe për të verifikuar në vazhdimësi punimet e themeleve, Kontraktori me shpenzimet dhe nën kujdesin e tij, do të sigurojë hapjen e vrimave të testimit dhe çdo investigim tjetër të tipit gjeoteknik.

Verifikimet e mësipërme dhe projektimet do të kryhen sipas praktikave më të mira.

Vizatimet e projektit për çdo strukturë, të firmosura nga Kontraktori dhe Design Inxhinier i tij duhet të tregojnë llojet dhe klasat e betonit, si edhe llojet dhe klasat e çelikut që do të përdoren. Këto duhet të miratohen nga Supervizori.

Sidomos përpara fillimit të punimeve për hedhjen e çdo strukture, Kontraktori duhet t'i dorëzojë Supervizorit në kohën e duhur për shqyrtim/ekzaminim sa më poshtë:

- Llogaritjet statike të strukturave dhe vizatimet e projektit (duke përfshirë linjat/vijat e influencës të deformimeve elastike) që siç specifikohen më sipër për t'u bërë funksionale duhet të kenë miratimin me shkrim të Supervizorit, i cili do t'i përfshijë ato në llogaritjet përfundimtare;
- Rezultatet e studimeve paraprake/fillestare të përzierjeve të kryera për çdo tip betoni, klasa e të cilit jepet në llogaritjet statike të punimeve të përfshira në tender me qëllim që të provohet që forca/fuqia e betonit të propozuar nuk është më e ulët nga ajo që kërkohej në projekt. Ky studim duhet të bëhet në një laborator të aprovuar/të certifikuar dhe duhet të përmbajë për çdo klasë: natyrën, burimin dhe cilësinë e agregateve, madhësinë përfundimtare e kokrizave, llojin dhe përmbajtjen e çimentos, raportin ujë/çimento, llojin dhe raportin e aditiveve, lloji i impjantit të përzierjes, vlera e pritshme e konsistencës së matur me konin e Abrahamit, sistemet e transportit, hedhja dhe përgatitja.

Supervizori do të autorizojë fillimin e hedhjes së betonit vetëm pasi të ketë marrë nga Kontraktori certifikatat e kualifikimit të studimeve paraprake siç jepet më sipër. Këto certifikate duhet të jenë lëshuar nga një laborator i certifikuar dhe pasi të jenë bërë kontrollet e duhura, duke përfshirë prova të metejshme laboratorike, siç përcaktohet në keto Specifikime.

Ekzaminimi dhe verifikimi nga Supervizori i dizenjave të punimeve dhe certifikatave të studimeve të kualifikimeve paraprake nuk e çliron Kontraktorin në asnjë mënyrë nga përgjegjësitë ligjore dhe kontraktuale, d.m.th. pavarësisht nga kontrollet që do të bëjë Supervizori gjatë zhvillimit të punimeve, vetë Kontraktori do të jetë plotësisht dhe direkt ligjorisht përgjegjës për punimet; kështu Kontraktori do të bëhet përgjegjës për inkonveniencën të çdo lloji natyre, rëndësie apo pasoje për ato që mund të ndodhin.

Për më tepër, Kontraktori do t'i paraqesë për ekzaminim Supervizorit projektet e punimeve të perkoheshme (qendërimi, punimet në harqe, punimet në kalëp, punimet e fshehta) përpara fillimit të punimeve me beton.

3.02 Komponentet

1. Çimentoja

Çimentoja që do të përdoret për përgatitjen e betonit duhet të plotësojë kërkesat e dispozitave në fuqi të Standardeve Ndërkombëtare të Punimeve Civile.

Ne rastet kur çimentoja është rifuxho, ajo do të transportohet me konteniere në mënyrë që të jete e mbrojtur nga lageshtia. Pompimi i çimentos në sillos do të bëhet në mënyrë të tillë që të parandalohet perzjere e një tipi me një tip tjetër.

Kontraktori do ta marrë cimenton nga ata prodhues që mund të sigurojnë cilësi të mirë, përputhshmeri me llojin e duhur dhe vazhdimësinë në furnizim. Kështu, me fillimin e punimeve, Kontraktori do t'i paraqesë Supervizorit një deklaratë ku të provohet që prodhuesit marrin përsipër furnizimin e sasise së parashikuar të çimentos, karakteristikat kimike dhe fizike të së cilës plotësojnë kushtet e pranimit. Kjo deklaratë është shumë e rëndësishme për Supervizorin që ai të japë miratimin e tij për furnizimin e çimentos nga prodhuesit e përzgjedhur, por kjo nuk e çliron Kontraktorin nga kontrollet periodike të cilësive të çimentos, që ai duhet t'i kryejë vetë edhe pa ia kërkuar një gjë të tillë Supervizorit. Këto kontrolle do të bëhen në një laborator të certifikuar për provimin/testimin e materialeve.

Provat do të perseriten në ato vende ku mund të lindin dyshime në lidhje me degradimin e cilësive të çimentos për çfarëdolloj arsyeje.

2. Agregatet

Agregatet duhet të jenë në përputhje me karakteristikat e specifikuara në Seksionin 2 ("Cilesia dhe burimi i materialeve") të ketyre Specifikimeve, dhe në vecanti ato nuk duhet të jenë cistoze apo silikomagneziane.

Nuk do pranohen agregatet që kanë më shumë se 15% të peshës me termija të zgjatura 5 herë më të mëdha se trashësia mesatare.

Agregatet e imet dhe të trashë, të perzjere në raportet e pershtatshme duhet të kenë gjithmone një përberje konstante të games së kokrizave që siguron arritjen e kushteve të dëshiruara si në perzjerjen e porsa përgatitur (përputhshmeri, homogjenitet, porozitet, etj) ashtu edhe në perzjerjet e forta (kapaciteti, përshkueshmëria, moduli i elasticitetit, viskoziteti, durueshmëria etj.)

Kurba granulometrike do të jete e tillë që të arrihet kompaktiteti maksimal duke përdorur dozen minimale të çimentos, dhe përputhshmeri me kërkesat e tjera.

Vëmendje e vecante duhet t'i kushtohet granulometrise së reres me qëllim që të minimizohet shpërthimi i çimentos.

Agregatet do të ndahen në së paku 3 fraksione; më të mirët do të kenë në përmbajtjen e tyre mbi 15% material të mbetur në një site 5 mm.

Fraksioni i një permase të caktuar nuk duhet të përmbajë më shumë se 15% kokriza të fraksioneve më të ulta dhe jo më shumë se 10% të fraksioneve më të mëdha.

Madhësia maksimale e agregatit duhet të jete e tillë që agregati të jete në gjendje mbushe çdo pjesë të strukture, duke marrë parasysh përpunueshmërinë e perzjerjes, hapësirat midis celikut të armimit dhe mbulimin e tij, karakteristikat gjeometrike të armatës dhe metodat e hedhjes dhe betonimit.

Sidoqoftë, dimensionet do të jenë gjithmone më të mëdha nga ato që janë parashikuar që plotësojnë kërkesat e strukture për të cilën nevojitet betoni; megjithatë, zakonisht nuk duhen kaluar masat e mëposhtme:

- 5 cm për punimet aktuale të themeleve
- 4 cm për punime të zakonshme në struktura
- 3 cm për betonarmete
- 2 cm për mbulesa apo shtresa të trashësive të kufizuara

3. Uji

Uji do të sigurohet nga burime të mire-percaktuara të cilat furnizojnë ujë sipas karakteristikave të miratuara nga Supervizori dhe që nuk kanë në përberjen e tyre naftë, acid, alkali dhe substanca bimore etj. Supervizori mund të urdherojë berjen e provave të pershtatshmerisë, të kohës për arritjen e markës duke e krahasuar me ato të përdorimit të ujit të distiluar.

Uji do të shtohet në sasite më të vogla të mundshme në lidhje me fuqinë/forcën e kërkuar dhe shkallën e punimit të betonit, duke marrë parasysh gjithashtu ujin që është në agregate me qëllim që të merret në konsideratë raporti i parashikuar ujë/cimento.

4. Aditivet

Supervizori do të vendosë nëse mund të përdoren ose jo aditivet e propozuar nga Kontraktori (forcues dhe vonues), mbi bazën e informacionit që disponohet nga punimet e mëparshme apo nga eksperimentimet. Me kërkesën e Supervizorit, Kontraktori do të sigurojë gjithashtu, nga një laborator i certifikuar/autorizuar, vërtetime të provave ku provohet që prodhimi është në përputhje me

rregulloret në fuqi; cilësia dhe përputhshmëria e karakteristikave të produkteve që do të përdoren duhet të jetë gjithësesi e garantuar.

3.03 Perzjerja e betonit

Betoni do të perzjehet në një impjant të prodhimit të betonit të dorëzuar paraprakisht për ekzaminim të Supervizorit të betonit. Impjantet e perzjerjes së betonit do të jenë automatike ose gjysem automatike, me matjen e peshës së agregateve, ujit, aditiveve të ndryshëm dhe cimentos; matja e cimentos do të bëhet gjithmone me pajisje të pavarur për matjen e peshës të precizionit të lartë. Matja efektive e agregateve do të bëhet me një precizion 3%; matja e cimentos do të bëhet me precizion 1%.

Mjetet matëse do të kontrollohen së paku një herë në dy muaj dhe do të kalibrohen në fillim të punës dhe më pas së paku një herë në vit çdo vit.

Matja e ujit dhe aditiveve mund të bëhet edhe në vëllim.

Matja efektive e ujit do të bëhet me një precizion 2% dhe mjetet perkatese do të kalibrohen së paku një herë në muaj.

Mjetet për matjen e cimentos, ujit dhe aditiveve do të jenë të tipit individual. Mjeti për peshimin e agregateve mund të jetë i tipit kumulativ (peshimi i masave të ndryshme).

Sillot e cimentos duhet të garantojnë hermetizimin perfekt në lidhje me lagështinë atmosferike.

Perzjerjet do të bëhen në perzjeresa betoni të një kapaciteti të tillë që të përmbajë të tere ingredientet e peshuar pa mbi-dozim.

Koha dhe shpejtësia e perzjerjes duhet të jetë e tillë që të prodhojë një perzjerje që plotëson kërkesat e homogjenitetit të specifikuar në paragrafin 12.03. Për çdo element tjetër të pa specifikuar do të aplikohen standardet e UNI 7163-79.

Perzjerja do të jetë uniforme dhe homogjene, si edhe uniformisht kohezive (d.m.th e tillë që të transportohet dhe të ngarkohet pa u ndarë elementet e vecante, (që të mos mbeten boshllëqe në masë ose në sipërfaqen e punimeve pas vibrimit operacional).

Punueshmëria nuk do të sigurohet duke hedhur me shumë ujë nga cka është parashikuar në përzierjen e çimentos. Supervizori mund të lejojë përdorimin e agjenteve të porozitetit, plastifikimit apo fluiditetit që nuk kanë qenë të parashikuar në studimet paraprake.

Në këto raste, përdorimi i këtyre agjenteve do të paguhet nga Kontraktori.

Më përjashtim të rasteve kur Supervizori mund të thotë ndryshe, i cili në këto rast do të parashtrojë kushtet dhe masat që do të merren, do të nderpritet prodhimi dhe hedhja e betonit në rast se temperatura shkon nën piken e ngirjes; në këto rast Kontraktori nuk i takon asnjë pagesë ekstra.

PJESA 4

KALLEPET, PUNIMET E FSHEHURA DHE FIKSIMET

4.01 Te përgjithshme

Për kryerjen e këtyre punëve të perkoheshme, qofshin të një natyre fikse apo të levizeshme, në drejtim vertikal ose horizontal, si edhe për instalimin e elementeve të strukturave parafabrikate, Kontraktori mund të përdorë sistemin, materialet dhe mjetet që ai sheh të përshtatshme ose me leverdi për to, duke konsideruar që ato plotësojnë kushtet e qëndrueshmërisë dhe të sigurisë, duke treguar kujdes për kryerjen perfekte të detajeve të ndërtimit.

Në projektin dhe kryerjen e punimeve të fshehura dhe fiksimit, Kontraktori do të zbatojë rregullat dhe detyrimet që mund të imponohen nga personat dhe Autoriteti përgjegjës lidhur me respektimin e planeve të vecanta ose strukturave ekzistuese në zonat e prekura nga ndërtimi i ri.

Punimet e cmontimit do të kryen në marreveshje me Supervizorin.

Në ndërtimin e punimeve të fshehura dhe fiksimit të çdo lloji, Kontraktori duhet të marrë masat e duhura që në të gjitha pikat e strukture ulja të e njëkoheshme.

Në projekt dhe në kryerjen e punimeve të fshehura dhe fiksimit, Kontraktori duhet gjithashtu të zbatojë rregullat dhe direktivat që dalin eventualisht nga Autoritet kompetentë lidhur me bllokimin kalimeve të ujit që nderpritën nga rruga ose lidhur me hapësirat që duhet të lihen të lira në rastin e mbikalimit të ndonjë rruge apo hekurudhe.

PJESA 5**SHTRIMI (ASFALTIMI) I RRUGEVE (KURRIZAT ARTIFICIALE)****5.01 Te pergjithshme**

Ne pergjithesi, me perjashtim te rasteve kur ne vizatimet e projektit percaktohet ndryshe, profili perfundimtar i kalimit te rruges per seksione gjatesore ka pjerrresi terthore prej 1.5%- 2.5%, qe lidhet me aksin e rruges me nje hark me tangente 0.5 m.

Pjerrësia e caktuar per bankinat do te jete 2.50%.

Kthesat do te inklinohen sic duhet ne anen e jashtme me nje pjerrresi qe do te caktohet nga Supervizori ne lidhje me rezen e ktheses dhe me kthesat e pershtatshme te tranzicionit qe do te lidhin inklinimin e pjese kryesore te ktheses me kurbat kalimtare apo me kthesa te tjera paraprirese apo vijuese.

Llojet dhe trashesite e shtresave te ndryshme qe perbejne trotuarin do te jene sipas percaktimeve te bera per cdo seksion ne vizatimet e projektit, por edhe mund te modifikohen nga Supervizori mbi bazen e rezultateve gjeoteknike dhe investigimeve laboratorike.

Kontraktori do t'i tregojë Supervizorit materialet, burimet e tyre dhe kategorizimin/klasifikimin e materialeve qe do te perdore, shtrese pas shtrese, ne perputhje me specifikimet e meposhtme.

Supervizori do te urdheroje te behen me keto materiale apo me materialet e tjera qe ai do te perzgjedhe. Keto prova do te behen ne laboratorin e kantierit apo ne laboratore te tjere te aprovuar. Keto prova do te perseriten ne menyre sistematike per te bere kontrollin e karakteristikave, gjate zhvillimit te punimeve ne labororet e kantierit.

Aprovimi nga ana e Supervizorit e materialeve, pajisjeve dhe metodave te punes nuk e çliron Kontraktorin nga pergjegjesia per zbatimin me cilesi te punimeve.

Me perjashtim te rasteve kur specifikohet ndryshe ne seksionet e meposhtme, siperfaqja e perfunduar e rruges se shtruar/trotuarit nuk do te ndryshojë nga profili i dizenjës me shume se 1 cm. Kjo do te kontrollohet me nje late 4.50 metra te gjate, sipas te dy drejtimeve ortogonale.

Trashesia e shtrimit te rruges mbi ura do te jete e tille qe pjeset e siperme te ures dhe hidroizolimi i shtruar mbi te te jene te mbrojtura nga amortizimi normal dhe veprimi i drejtperdrejte i trafikut. Sidoqofte, kjo trashesi nuk duhet te jete me e vogel se 8 cm.

Per te shmangur riveshjet e shpeshta, qe jane vecanerisht te kushtueshme mbi ura, i gjithë asfalti, duke perfshire edhe fugat dhe punime te tjera aksesore do te ndertohen me materialet e cilesise me te mire dhe me fuqine me te kualifikuar punetore.

5.02 BINDERI dhe shtresat e asfaltbetonit (tapeti)**(1) Pershkrimi**

Pjesa e siperme e asfaltit te rruges ne pergjithesi perbehet nga nje shtrese e dyfishte asfaltbetoni e shtruar e nxehte, d.m.th nje shtrese e poshtme binderi dhe nje shtrese e siperme asfaltbetoni sipas vizatimeve te projektit ose sipas udhezimeve te Supervizorit.

Materiali per te dyja shtresat do te perbehet nga nje perzjerje e aggregateve te holle te thermuar, rere dhe filer mineral, te perzjere me asfalt te nxehte ne nje impjant qendror dhe do te shtrohen me vibratory finishing machine dhe do te ngjishen me rula pneumatike ose celiku.

(2) Materialet e aggregateve

Per ekzemplaret e aggregateve te testuar ne lidhje me pershtatshmerine e tyre, si edhe per metodat per zbatimin e provave do te aplikohen specifikimet C.N.R.

Agregatet e shtreses do te perftohen nga thermimi i shkembinjve ose zhavorrit dhe do te perbehen nga elemente te shendoshe, te forte, afersisht poliedrike, te mprehte me siperfaqje te ashper, te paster dhe pa asnje lloj pluhuri apo materiali te huaj ne perberjen e tyre.

Midis bazes se asfaltit dhe shtreses se binderit dhe midis shtreses se binderit dhe shtreses se asfaltbetonit do te shtrohet nje veshje ngjitesore prej 0.5 kg/m² bitum ne 55% emulsion, ne rast se shtresa e siperme nuk eshte shtruar menjehere pas ngjeshjes se shtreses se poshtme apo ne rast se temperatura e saj ka rene nen 105 grade Celsius.

Agregatet e shtreses mund të jenë nga burime të ndryshme apo me natyrë petrografike të ndryshme, poqese provat që mëposhtë vijojnë të bëra me kampionet e çdo termi granulemetrike plotësojnë kërkesat e mëposhtme.

Per shtresat e nimderit:

- Prova e abrazionit të Los Anxhelos-it e bëre me fraksionin A caktuar granulemetrik; humbja e peshës e barabartë ose nën 30%;
- Treguesi i boshllëqeve në fraksionin e caktuar granulemetrik sipas specifikimeve C.N.R; nën 0.80.
- Koeficienti i thithjes sipas specifikimeve C.N.R: më pak se 0,015;
- Në rast se mbi shtresën e binderit pritët të kalojë trafik gjatë periudhës të lagës apo gjatë dimrit, humbja e peshës me tundje do të kufizohet në 0.5%

Per shtresat e asfaltbetonit:

- Prova e abrazionit të Los Anxhelos-it e bëre me fraksione të caktuara granulemetrike; humbja e peshës e barabartë ose nën 25%, por sidoqoftë jo më e madhe se 30%
- Në paku, 30% me peshë e të gjithë agregatit do të përfitohet nga shkëmbinjtë me një koeficient termimi me të ulët se 100 dhe një fuqi kompresuese, në të gjitha drejtimet jo më pak se 140 N/mm².
- Treguesi i boshllëqeve në fraksionet e caktuara granulemetrike: nën 0.85
- Koeficienti i thithjes: më pak se 0,015
- Karakter jo-hidrofolik

Per bankinat e asfaltuara apo vendpërdorimet, do të përdoren agregatet e specifikuar më sipër për shtresat e binderit dhe asfaltbetonit.

Në të gjitha rastet, agregati i shtresës do të përbehet nga elemente të shëndoshe, të forta, rezistent, të mprehtë, afërsisht poliedrike dhe me sipërfaqje të ashpër, por gjithmone pa prezencën e pluhurave dhe materialeve të huaja.

Agregati fin do të përbehet në të gjitha rastet nga rërë natyrore ose rërë e termuar që plotëson kërkesat e specifikimeve të mësipërme dhe në vecanti:

- Ekuivalenti i rërës, jo më pak se 55%;
- Karakter jo-hidrofiliq sipas specifikimeve C.N.R me kufizimet e përcaktuara për agregatet e shtresës. Në rast se nuk do të ishte e mundur të sigurohej material me madhësi 2-5 mm që është madhësia e duhur për provën, kjo do të bëhet sipas metodës së provës Riedel-Weber me përqendrim jo më pak se 6.

Fileri mineral do të përbehet nga shkëmb, pluhur apo çimento me prejardhje gëlqerore, gëlqerë e hidratuar, pluhur asfalti, me një kalueshmëri 100% në Siten 0.5 mm përmes seleksionimit në të thatë dhe me një kalueshmëri së paku 65% në Siten 0.075.

Per shtresën e asfaltbetonit, në rast se kërkohet nga Supervizori, fileri mund të jetë prej pluhuri shkëmbor asfaltik me përmbajtje: bitum 6-8% dhe një përqindje të lartë asfalti me depertim Dow 25 grade Celsius në 150 dmm.

Fillers të ndryshëm nga ata të përshkruar më sipër do të kërkojnë me parë miratimin e Supervizorit mbi bazën e provave dhe kërtimeve laboratorike.

(3) Asfalti

Lidhesat asfaltike për shtresat e binderit dhe shtresat e asfaltbetonit do të kenë mundësi të një depertimi nga 80-100, me përjashtim të rasteve kur Supervizori vendos ndryshe duke patur parasysh kushtet lokale dhe sezonale dhe do të jenë në përputhje me të njëjtat specifikime të dhëna më sipër për bazën e asfaltit, ku pika e zbutjes do të jetë midis 47 grade Celsius dhe 56 grade Celsius.

(4) Perzjerjet

a. Shtresa e binderit. Agregati që do të përdoret për shtresën lidhëse do të jetë në përputhje me shkallëzimin e mëposhtëm:

Sieve designation Kërkesa e shkallëzimit: % e kalueshmerisë me peshë (mm)

25	100
15	65-100
10	50-80

5	30-60
2	20-45
0.4	7-25
0.18	5-15
0.075	4-8

Permbajtja e bitumit do të jete midis 4- 5.5% të peshes së agregateve. Boshlleqet totale në perzjerjen e mbushur me asfalt do të jene midis 60-80%. Sidoqofte, ky do të jete minimumi që lejon arritjen e stabilitetit Marshall dhe vlerave të ngjeshjes që jepen me poshte.

Perzjerja e asfaltit që do përdoret për të formuar shtresën lidhëse do të duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Stabiliteti Marshall në 60 grade C në të gjitha rastet do të jete i barabartë ose mbi 900 kg. Për më tepër, vlera e ngurtësisë Marshall, d.m.th raporti midis stabilitetit të matur në kg dhe rrjedhjes së matur në milimetra do të jete në të gjitha rastet mbi 300. Të njëjtet kampione do të kene një përqindje të porozitetit nga 3-7%.

Prova Marshall e bëre me kampionet të cilat kanë kaluar një periudhë zhytjeje në ujë të distiluar për 15 dite do të kene një vlerë stabiliteti jo nën 75% të asaj që është specifikuar më parë. Ekzemplare të provave të mesipërme do të përgatiten në impjantin perzjerës. Temperatura e ngjeshjes do të jete e barabartë ose deri në 10 grade Celsius me atë të shtrimit.

b. Shtresa e asfaltbetonit

Perzjerja e agregateve që do të përftohet për shtresën e asfaltbetonit do të duhet të jete në përputhje me shkallëzimin e mëposhtëm:

Sieve designation Kërkesa e shkallëzimit: % e kalueshmerisë me peshe (mm)

15	100
10	70-100
5	43-67
2	25-45
0.4	12-24
0.18	7-15
0.075	6-11

Permbajtja e bitumit do të jete nga 4.5-6% të peshes së agregateve.

Boshlleqet e mbushura me bitum të perzjerjes së ngjeshur do të jene nga 70-80%; permbajtja e bitumit në perzjerje do të jete minimumi që lejon arritjen e stabilitetit Marshall dhe vlerat e ngjeshjes të përcaktuara më poshte.

Betoni i asfaltit do të duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Rezistenca tërë të lartë mekanike, d.m.th kapaciteti për të duruar pa deformime të përherëshme forcat/shitjet të transmetuara nga rrotat e makinave si dinamike ashtu edhe statike, edhe gjatë temperaturave më të larta të verës dhe të këte fleksibilitetin e mjaftueshëm për të ndjekur nën të njëjtat ngarkesë çdo uljet eventuale të themelit edhe gjatë periudhave të gjatë kohore; vlera Marshall e stabilitetit arritur në 60 grade C do të jete së paku 1,000 kg. Për më tepër, vlera Marshall e ngurtësisë, d.m.th raporti midis stabilitetit të matur në kg dhe rrjedhjes së matur në milimetra do të jete në të gjitha rastet mbi 300. Përqindja e boshlleqeve të kampioneve të mesipërme do të jete midis 3-6%. Prova Marshall e kryer me kampionet që kanë kaluar një periudhë të zhytur në ujë të distiluar për 15 dite do të japë një vlerë stabiliteti që nuk duhet të jete më e ulët se 75% të atyre që janë paraqitur më parë;

- Rezistenca shumë të lartë ndaj amortizimit të sipërfaqjes;
- Sipërfaqja e përfunduar duhet të jete aq e ashpër sa të mos behet e rreshqitshme;
- Ngjeshje të lartë: vëllimi i poreve pas ngjeshjes do të jete midis 4-8%.

Një vit pas hapjes së trafikut, vëllimi i poreve do të jete midis 3-6% me papershkueshmeri pothuajse të plote; koeficienti i pershkueshmerisë i matur në kampionet Marshall, nuk do të jete më i lartë nga 10-6 cm/sek.

Ne lidhje me perzjerjet e asfaltike per shtresen e binderit dhe per shtresen e asfaltbetonit, ne ato raste kur prova Marshall behet per te kontrolluar stabilitetin e perzjerjes se prodhuar, kampionet perkatese do te perгатiten me materialin qe eshte marre nga impjanti i prodhimit dhe qe eshte ngjeshur me pare pa e nxehur me tej. Ne kete menyre, temperatura e ngjeshjes do te lejoje gjithashtu kontrollin e temperaturave operuese.

(5) Kontrolli i kerkesave per pranim

Do te zbatohen te njejtat kerkesa me ato te percaktuara per shtresen baze.

(6) Pergatitja e perzjerjeve

Do te zbatohen te njejtat kerkesa me ato te percaktuara per shtresen baze, me perjashtim te kohes minimale per nje perzjerje efikase e cila nuk do te jete me pak se 25 sekonda.

(7) Lidhesit

Ne perгатitjen e perzjerjeve te asfaltit per shtresa te ndryshme mund te perdoren substanca te vecanta kimike qe aktivizojne lidhjen asflat-agregat (adhesion dopes).

Substancat qe perdoren per lidhje mund te perdoren per shtresat baze dhe binderin, ndersa per shtresen e asfaltbetonit perdorimi i tyre varet nga udhezimet e Supervizorit.

a. kur kantieri eshte aq larg nga impjanti perzjerjes saqe nuk siguron dot temperaturt 130 grade Celsius qe kerkohet ne kohen e shtrimit (ne lidhje me kohen e transportimit te betonit per asfalt);

b. kur per shkak te kushteve atmosferike, shtrimi i perzjerjes se asfaltit nuk mund te vonohet si pasoje e kerkesave te trafikut dhe sigurise.

Duhet bere kujdes per te perzgjedhur nga produktet qe jane ne dispozicion ne treg, ate produkt qe mbi bazen e provave krahasuese te bera ne labororet e autorizuar, do te kete dhene rezultatet me te mira dhe qe i ruan karakteristikat e veta kimike edhe pasi te jete ne kontakt me temperatura te larta per periudha te zgjatura kohore.

Pjesa mund te varioje sipas kushteve te perdorimit, natyres se agregateve dhe karakteristikave te produktit nga 0.3%- 0.6% ne lidhje me peshen e asfaltit.

Llojet, proporcionet dhe teknikat e perdorimit do te miratohen paraprakisht nga Supervizori.

Futja e substancave te vecante kimike lidhese ne impinat do te behet me pajisjen e duhur per te siguruar shperndarjen e duhur dhe proporcionin ekzakt.

PJESA 6

Sinjalistika Rrugore

6.1 Pershkrim

Keto punime do te konsistojne ne furnizimin dhe vendosjen e sinjalistikes rrugore ne perputhje me specifikimet, ne vendet dhe me dimensioned e treguara ne vizatimet ose sic udhezohet nga Inxhinieri.

E gjithë sinjalistika rrugore do te bazohet ne madhesine, formen, ngjyren dhe simbolet e dhena ne Kodin Rrugor..

Shenjat rrugore do te jene te dy tipeve si me poshte :

Tipi I I shenjave rrugore, perfshin rregullat, te paralajmerimet dhe shenjat e informacionit standart.

Tipi II I shenjave rrugore, perfshin panelet e drejtimit dhe shenjat e kilometrazhit.

6.2 Materialet dhe Ndertimi

Betoni per vendosjen e shenjave do te jete i Klases 200 dhe do te realizohet sipas Specifikimeve te Pergjithshme.

Mbajteset e shenjave do te jene tuba te galvanizuar celiku me gjatesi 3,5 deri ne 5,0 m dhe me diameter te jashtem minimal 60 mm.

Pllaka e shenjes do te jete nje flete e galvanizuar celiku 10/10 ose flete alumini e trajtuar me trashesi 25/10 cm.

Veshja reflektuese do te jete Engineer Grade Scotchlite ose prodhim i ngjashem, sic miratohet nga Inxhinieri.

Kontraktori do te prodhoje me shpenzimet e tij, specifikimet e prodhimit per te gjitha materialet qe ai ka per qellim te adoptoje (per shenja rrugore) se bashku me certifikaten e dhene nga prodhuesi duke

vendosur emrin dhe marken e materialeve që do të furnizohen, dhe cdo të dhënë tjetër të kërkuar nga Inxhinieri.

Kontraktori do të paraqesë gjithashtu, me shpenzimet e tij, një garanci nga prodhuesi që të gjitha materialet e furnizuara janë konform me kërkesat e specifikimeve.

Në cdo kohë Inxhinieri mund të kërkojë cdo provë që ai e mendon të nevojshme për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve nga ana e materialeve, me shpenzimet e Kontraktorit.

Pllakat e shenjave të prodhuara me flete metalike do të përforcohen kur dimensionimi maksimal i shenjes kalon 600 mm.

Themelet për shenjat rrugore do të tregohen në vizatimet ose do të jenë sipas udhëzimeve të Inxhinierit. Kujdes duhet treguar për të parandaluar forcën përdredhese të shenjes mbi bazament dhe të bazamentit mbi themelet e tij.

Të gjitha strukturat e paneleve të drejtimit duhet të mbajnë sforcimin e shkaktuar nga era me shpejtësi 130 km/h mbi bazamentet dhe shenjat.

Shenjat duhet të vendosen në një distancë nga ana e rrugës e cila varet nga standarti i projektimit, sipas udhëzimeve të Inxhinierit dhe në lartësi 2,1m nga kuota e kurores së rrugës.

Kontraktori do të presë pemet dhe bimët në mënyrë që të sigurojë fushëpamjen e shenjave.

Model vizime rrugore.



Model guardrail N2 anesore.



Llojet e tabelave rrugore/ Kurrizave artificiale, bllokuese të betonit:



1.TABELË RRETHORE NORMALE D=60, "NDALIM QARKULLIMI" (MJETE ME TONAZH MBI 7.5 TON)



2.TABELË RRETHORE NORMALE D=60, "NDALIM QARKULLIMI" (MJETE ME TONAZH MBI 3.5 TON)




3.TABELË RRETHORE NORMALE D=60, "KUFIZIM SHPEJTËSIJE" (DERI NË 30KM/H)




4.TABELË RRETHORE NORMALE D=60, "KUFIZIM SHPEJTËSIJE" (DERI NË 40KM/H)



5.TABELË RRETHORE NORMALE D=60, "NDALIM QARKULLIMI" (NË NJËRIN SENS)



6.TABELË RRETHORE NORMALE D=60, "NDALIM QARKULLIMI" (NË DY SENSET)



7.TABELË RRETHORE NORMALE D=60, "NDALIM QËNDRIMI" (NË DY ANËT E RRUGËS)



8.KURRIZË ARTIFICIALE (PLASTIKE) RRUGE H=5CM (50CMX100CM)**9.KURRIZË ARTIFICIALE RRUGE ME ASFALTOBETON (BINDER T=6CM+TAPET T=4CM), B=5M, L=6-8M, H=10CM.****6.3 Pagesat**

Shenjat rrugore do të paguhen me cmimin për meter katror të shenjes së instaluar (vizimet), me cmim për copë (tabelat) dhe me cmim për ml (Guardrail). Cmimi do të kompensojë plotësisht furnizimin dhe vendosjen e materialeve përfshirë të gjithë fuqinë punëtore, pajisjet, mjetet e punës dhe ato ndihmëse të nevojshme për të përfunduar punën e përshkruar në këtë seksion, duke përfshirë gjithashtu të gjitha gërmimet dhe mbushjet e nevojshme.

PJESA 7**SPECIFIKIMET SIPAS ÇMIMEVE****6.01 Specifikimi i cmimit njësi**

Brenda cmimit njësi të çdo zeri punimesh do të përfshihet: Shpenzimet për blerjen e materialeve, shpenzimet për makinerinë, shpenzimet për puntorinë, specialistët e manovratorët, përfshirë sigurimet shoqërore shëndetësore, shpenzimet për transportin e materialeve nga gurëthyeset/pikat e tregimit etj deri në objekt.

Gjithashtu në cmim do të përfshihen dhe shpenzimet për ngjitjen e kantjerit, për provat laboratorike e testimet, shpenzimet suplementare dhe fitimi i planifikuar.

Gjithashtu në cmim do të përfshihen dhe shpenzimet e stafit inxhinierik e hartografik.

SPECIFIKIMET TEKNIKE U PERGATITEN NGA

"ERLAD-G" sh.p.k.

ing. Gezim ISLAMI